



KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odaljenje za Opštu Upravu



-III- Nr. I prot. 1967 M8 26-05 20 21
Br. prot. Dt. RAHOVEC - ORAHOVAC

ANEKS KONTRATA

RREGULLIMI I VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE CIVILËVE – LOT II

Numri i kontratës: 623-21-2119-5-3-5/C259

Nr. i brendshëm: 623-20-028-5-2-1/5

Autoriteti Kontraktues: KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË, dhe

GZIMI-GARTEN-UND LANDSCHAFTSBAU SH.P.K., Sheshi Ilimi Maliqi, Rahovec, të cilën e përfaqëson: Petrit Veliu, në tekstin e mëtejshëm ("Kontraktuesi"), janë pajtuar të lidhin këtë Aneks kontratë:

- I. Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e punëve për: Rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe civilëve – Lot II, me Numër të prokurimit: 623-20-3325-5-2-1 & 623-20-028-5-2-1, të datës: 27.08.2020, e cila kontratë është në realizim e sipër.
- II. Duke u bazuar në kërkesën për punë shtesë nga menaxheri i projektit dhe arsyetimet për mospërfshirjen e punëve shtesë në kontratën bazë, në njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vendimin mbi aprovimin e punëve shtesë të kontratës dhe kryerjen e suksesshme të punëve për: Rregullimi i varrezave të dëshmorëve dhe civilëve – Lot II, Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi pajtohen që të lidhin aneks kontratë për kryerjen e punëve shtesë sipas ofertës së datës: 15.04.2021, me kushte të njëjta si në kontratën bazë.
- III. Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit, ndërsa ekzekutimi i punëve dhe/ose shërbimeve duhen të përfundohen në afat jo më të gjatë se: 10 ditë pune pas fillimit të ekzekutimit të Punëve dhe/ose Shërbimeve.

ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

1. Kontrata bazë që është duke u përmbushur, është vazhduar edhe për kryerjen e punëve shtesë të pa parashikuara si marrëveshje reciproke në mes palëve.
2. Çmimi i punëve shtesë është gjithsej: 2,770.00 €
(Dy mijë e shtatëqindeshtatëdhjetë Euro e zero Cent)
sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna në Dosjen e tenderit nr. [623-21-2119-5-3-5/C259 & 623-20-028-5-2-1/5].
3. Punët shtesë kontraktohen bazuar në përshkrimin e punëve shtesë të Menaxherëve të Projektit, Njoftimit në KRPP dhe kushteve të negociuara në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që janë pjesë e këtij Aneksi të Kontratës.
4. Pagesa e punëve shtesë do të bëhet në bazë të konstatimit të Personave të Autorizuar të Autoritetit Kontraktues pas perfundimit të punëve.
5. Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
 - a. Marrëveshja e kontratës;
 - b. Përshkrimi i punëve shtesë nga Menaxherët e projektit që duhet të realizohen;
 - c. Njoftimi në KRPP për punët shtesë.
6. Të gjitha kushtet tjera të kontratës bazë mbesin të njëjta.

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:		Për Kontraktuesin:	
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Petrit Veliu
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	26.05.2021	Data:	26.05.2021
Vula:		Vula:	

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR RREGULLIMIN E VAREZAVE TË
MARTIRËVE NË RAHOVEC**

Nr.Pos.	Përshkrimi i Posicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1	Demontimi me kujdes i rretës prej metali të murit prej gabioneve me të mbushur me gur me fraksion (32-63)mm me gjerësi të murit b=25cm dhe lartësi h=80cm, në çmim të llogaritet edhe montimi dhe vendosja e murit prej gabioneve në vendin e caktuar nga autoriteti kontraktues.	m	24	15.00	360.00
2	Gërmimi i dhut të kategorisë së tretë për hapjen e themeleve shiritore, me gjatësi b=30cm, dhe thellësi h=80cm, ngarkimi dhe transporti në deponi në largësi deri në 5km.	m ³	10	3.00	30.00
3	Prerja, pastrimi, dhe gërmimi sipërfaqësor i barishteve, kaqubave, bagremave dhe lisave tjerë së bashku me rënjë, ngarkimi dhe transportin në deponi në largësi deri në 5km.	m ²	500	0.50	250.00
4	Gërmimi sipërfaqësor në thellësi deri në 50 cm dhe rrafshimi sipërfaqësor i dheut të kategorisë së III-të.	m ²	500	0.90	450.00
5	Furnizimi, transporti dhe betonimi i themeleve të mureve prej betoni të armuar me beton të klasës së soloditetit në shtypje C25/30Mpa. Në çmim të llogaritet edhe armimi i themelit me armaturë 4 Ø12 dhe stafa Ø8 çdo 20cm.	m ³	10	85.00	850.00
6	Furnizimi, transporti, montimi i pahive, armimi dhe betonimi i mureve prej betoni të klasës së soloditetit në shtypje C25/30Mpa. Muret të jenë me gjerësi b=20cm dhe lartësi h=50cm. Në çmim të llogaritet edhe armimi i mureve me armaturë Q335 në të dy anët e murit.	m ³	4	95.00	380.00
7	Furnizimi, transporti, shtruarja, rrafshim dhe ngjeshja e zhavorit me fraksion fr.(0-32)mm në trashësi prej t=20cm.	m ³	90	5.00	450.00
Gjithsej Punët:					2,770.00

Punëkryesi:

'G.G.L.' Sh.P.K.

